

**Njoftimi i përqendrimit me të cilin KEN BIDKO LIMITED, Mbretëria e Bashkuar do të fitoj kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi Kin end Karta Plc, Angli**

**(lënda nr. 08-23/2024)**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 22.01.2024, te Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim ku KEN BIDKO LIMITED me seli në 10-14 Vajt Lajn Strit, Londër, Mbretëria e Bashkuar do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi Kin end Karta Plc, me seli në D Spitfajr Biding, 71 Kolier Strit, Londër, Angli.

- KEN BIDKO LIMITED është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Angli dhe Vells. Shoqëria e saj mëmë e drejtpërdrejtë është Turing Luks Bidko 2 S.a. r.l. ("**Touring Lux Bidco 2**"), e cila është gjithashtu shoqëria mëmë e Grupit Valtek ("**Valtek**"). Turing Luks Bidko 2 është në pronësi dhe e kontrolluar nga BC Partners XI.

BC Partners është një firmë ndërkombëtare e investimeve me pronë prej rreth 40 miliardë euro nën menaxhim në strategjitë e kapitalit privat, kredive private dhe pasurive të paluajshme. BC Partners XI së bashku me fondet e tjera të kapitalit privat të këshilluara nga BC Partners të listuara këtu si "**BC fondovi**", dhe kompanitë e portofolit të kontrolluara nga fondet BC janë renditur këtu si "**Kompanitë e Portofolit BC**". Fondet BC kanë një pjesë kontrollues në 34 kompani portofoli. Fondet BC janë investitorë të pastër financiarë, gjegjësisht nuk janë të përfshirë në menaxhimin e përditshëm të kompanive në të cilat investojnë, të cilat menaxhohen nga ekipe të pavarura drejtuese.

Valtek ka një filial në Maqedoninë e Veriut, kompaninë Valtek Shpknpj Skopje me seli në rr. Stoltenbergova nr. 4, lamella A/majtas Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut me aktivitet prioritar - programim kompjuterik.

Për më tepër, Junajted Grup, e cila është një kompani portofoli e BC, ka tre filiale në Maqedoninë e Veriut:

-Total TV SHPK Shkup me seli në Bul. VMRO nr. 3, Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut me aktivitet prioritar - aktivitetet e telekomunikacionit satelitor; -UGI FIBER SHPKNJP me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 14, Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut me aktivitet prioritar - aktivitetet e telekomunikacionit satelitor dhe

- Direct Media DOEL Shkup me seli në Kosta Veselinov nr.5-1 lokal 2/Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut me aktivitet prioritar - agjenci marketingu.

-Kin end Karta Plc është një kompani globale konsultative e transformimit digjital që u shërben bizneseve në kujdesin shëndetësor, shërbimet financiare, industrinë dhe bujqësinë, shitjen me pakicë dhe shpërndarjen, transportin dhe sektorin publik, ndër të tjera. E njohur më parë si Sent Ivs plc (*Sent Ives plc*), Kin end Karta ka evoluar nga një grup shërbimesh printimi dhe marketingu në një kompani konsultative për transformim digjital, e fokusuar në ofrimin e rezultateve të lidhura për klientët përmes inovacionit digjital, modernizimit të resë (angl. Cloud) duke mundësuar të dhëna dhe optimizim digjital. Selia e Kin end Karta është në Londër, me seli në SHBA në Çikago dhe ka mbi 1,800 konsulentë, inxhinierë dhe shkencëtarë të të dhënave në mbarë botën.

Kin end Karta ka një ndërmarrje-bijë në Maqedoninë e Veriut, shoqërinë Kin end Karta Makedonija SHPKNJP Shkup me seli në rr. 1737 nr. 32 Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut me aktivitet prioritar - programim kompjuterik.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit në fjalë, tregu relevant i produkteve mund të përkufizohet si: Shërbimet e TI-së në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk) dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

29.01.2024

Shkup